



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (ZKM) NR. 08/2023 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË SË
REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË¹**

¹ Rregullore ZKM-Nr. 08/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 618/228, të datës 15.12.2023.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

**RREGULLORE (ZKM) NR. 08/2023 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË SË REGJISTRIMIT TË
BIZNESEVE NË KOSOVË**

KAPITULLI 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Kompetencat e përgjithshme për fushën e regjistrimit të bizneseve përcaktohen me Ligjin përkatës për Shoqëritë Tregtare si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI II

**ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË
KOSOVË**

**Neni 3
Misioni i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë**

Misioni i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë është regjistrimi i të gjitha llojeve të shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë,

Subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, kërkesave, kushteve dhe procedurave të regjistrimit, ndryshimi dhe çregjistrimi për secilin lloj të shoqërive tregtare.

Neni 4

Struktura Organizative e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

1. Struktura Organizative e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë është si vijon:

1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë është njëzetë e tetë (28).

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë përbëhet nga:

1.1. Drejtori Ekzekutiv;

1.2. Një (1) Zyrtar Administrativ.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, dhe Ligjin përkatës për Shoqëritë Tregtare.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Administrativ të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarët publikë.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është dy (2).

Neni 6

Divizionet e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

1. Divizionet e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve janë:

1.1. Divizioni për Regjistrimin e Bizneseve;

1.2. Divizioni për Regjistrimin e Pengut;

1.3. Njësia për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm.

Neni 7
Divizioni për Regjistrimin e Bizneseve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Regjistrimin e Bizneseve janë:
 - 1.1. Futjen e të dhënave në sistemin e para regjistrimit të bizneseve, në bazë të llojeve të biznesit;
 - 1.2. Shqyrtimin e kërkesave për regjistrim biznesi si dhe verifikimin e të dhënave në sistemin elektronik;
 - 1.3. Krijon arkivin elektronik në para regjistrim duke skanuar dokumentacionin;
 - 1.4. Shqyrtimin dhe aprovimin e aplikacioneve për regjistrim të bizneseve, ndryshim dhe shuarje të bizneseve;
 - 1.5. Përgatitjen e vendimeve për regjistrime të bizneseve, njoftimeve, shkresave dhe pezullimin e aplikacioneve të regjistruara;
 - 1.6. Shqyrton dhe trajton ankesat e ndryshme lidhur me regjistrimet e bizneseve;
2. Udhëheqësi i Divizionit për Regjistrimin e Bizneseve raporton tek Drejtori Ekzekutiv i ARBK-së.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Regjistrimin e Bizneseve është nëntëmbëdhjetë (19).

Neni 8
Divizioni për Regjistrimin e Pengut

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Regjistrimin e Pengut janë:
 - 1.1. Siguron ligjshmërinë dhe mirëmbajtjen e Regjistrimit të pengut;
 - 1.2. Administrimin e Regjistrimit, Ndryshimit dhe Shlyerjen e Pengut;
 - 1.3. Hartimin e propozimeve vendimeve për Regjistrimin e Pengut;

- 1.4. Regjistrimin, Ndryshimin dhe Shlyerjen e Pengut, përmes Sistemit për Regjistrimin e Pengut;
- 1.5. Siguron procesin efektiv në kërkimin e informacioneve përmes Sistemit për Regjistrimin e Pengut;
2. Udhëheqësi i Divizionit për Regjistrimin e Pengut raporton tek Drejtori Ekzekutiv i ARBK-së.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Regjistrimin e Pengut është tre (3).

Neni 9

Njësia për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm janë:
 - 1.1. Përgatitë dokumentacionin e përpunuar për arkivim;
 - 1.2. Pranimi i dërgesave, shkresave dhe emailave të adresuara në ARBK, si dhe evidentimi i tyre në librin e protokollit dhe ndarja e tyre.
 - 1.3. Mbikëqyrë dhe ndihmonë në zhvillimin e sistemit të bazës së të dhënave;
 - 1.4. Regjistron çdo hyrje në arkën e ARBK-së, regjistrimin e pagesave të dorëzuara nga bizneset, koordinimin e aktiviteteve me të gjitha Qendrat Komunale të Bizneseve në fushën e pagesave;
2. Udhëheqësi i Njesisë për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm raporton tek Drejtori Ekzekutiv i ARBK-së.
3. Njësia për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm është njësi organizative ekuivalente me Divizionin.
4. Numri i të punësuarve në Njësinë për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm është katër (4).

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 10

Dispozita kalimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 11 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen nenet 65 deri 71 të Rregullores nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 12 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Me 15/12/2023

**Organogrami i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK)**

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçant)	Numri
1. Drejtori Ekzekutiv	Drejtues/e i/e Lartë 2		Totali:2
-Zyrtar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1 1
1.1. Divizioni për Regjistrimin e Bizneseve			Totali:19
- Udhëheqës i Divizionit për Regjistrimin e Bizneseve	Drejtues/e i/e Ulët		1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave.	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave.	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Çështje Praktike dhe Regjistrim Biznesi.	Profesional 2	1. Gr. Specialist ligjor	1
- Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve.	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1
- Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve.	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1
-Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve.	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1
- Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve.	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1
-Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1

-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar/e për Procesimin e të dhënave	Profesional 3	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
1.2. Divizioni për Regjistrimin e Pengut			Totali:3
-Udhëheqës i Divizionit për Regjistrimin e Pengut.	Drejtues/e i/e Ulët		1
- Zyrtar/e për Regjistrim të Pengut.	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtar/e për Regjistrim të Pengut.	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
1.3. Njësia për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm			Totali: 4
- Udhëheqës i Njesisë për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm	Drejtues/e i/e Ulët		1
-Zyrtar/e i Lartë për Teknologji Informativ.	Profesional 1	51.Gr.Specialist i bazave të të dhënave	1
-Zyrtar/e për të Hyra dhe Regjistrim të Pagesave.	Profesional 2	11.Gr.Specialist i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	1
-Zyrtar/e i/e Pranimi të Aplikacioneve.	Profesional 3	9. Gr.Specialist i arkiv-dokumentacionit	1

Organogrami i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK)

